

UDHËZIM
Nr.274, datë 5.5.2009

PËR “PAJISJEN, PËR HERË TË PARË, ME LETËRNJOFTIM, TË SHTETASVE SHQIPTARË TË MOSHËS MBI 18 VJEÇ DHE PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE E TË MASAVE SHTRËNGUESE, PËR ATA, QË NUK APLIKOJNË BRENDA KËTYRE AFATEVE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e “Kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, si dhe të nenit 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 7.1.2009 “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Të gjithë shtetasit që janë në moshën mbi 18 vjeç, në datën 28 qershor 2009, dhe nuk disponojnë pasaportë, janë të detyruar të pajisen me letërnjoftim deri më datë 15 maj 2009.

2. Shtetasit e përmendur në pikën 1 të këtij udhëzimi, nëse nuk pajisen me letërnjoftim deri më 15 maj 2009, nuk përfitojnë shërbimet e mëposhtme:

a) Pagesën ose shpërblimet për të gjithë personat fizikë, të punësuar në administratën dhe institucionet publike, si dhe për personat e punësuar në shoqëri, agjenci e ente shtetërore, qendrore apo vendore;

b) Pagesën për ndihmë, përkrahje sociale apo çdo lloj ndihme tjetër, ofruar nga institucionet publike qendrore dhe vendore;

c) Pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit;

d) Shërbimin në zyrat e gjendjes civile, me përjashtim të regjistrimit të akteve të lindjes dhe të vdekjes.

3. Ofrimi i shërbimeve, të parashikuara sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, do të bëhet përkundrejt paraqitjes nga subjektet pranë organit përkatës, në momentin e kërimit të shërbimit, letërnjoftimin ose formularin e aplikimit për letërnjoftim. Në rast se subjekti disponon vetëm formularin e aplikimit për letërnjoftim, dorëzimi i letërnjoftimit duhet të bëhet brenda një afati jo më shumë se dy javë.

4. Të gjithë ofruesit e shërbimeve që nuk zbatojnë kërkesat e këtij udhëzimi, mbajnë përgjegjësi dhe përgjigjen sipas dispozitave të parashikuara në pikën 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 7.1.2009 “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim, të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata, që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, i ndryshuar.

5. Ngarkohen të gjitha institucionet në varësi të Ministrisë së Brendshme, që ofrojnë shërbimet e përmendura në pikës 2, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani